



REPUBLIKA E SHQIPËRISË
PROKURORIA E PËRGJITHSHME
PROKURORI I PËRGJITHSHËM

Nr. 540 prot.

Tiranë më, 24.03.2020

UDHËZIM I PËRGJITHSHËM

Nr. 04, datë 24.03.2020

**MBI MASAT ADMINISTRATIVE PËR MBARËVAJTJEN E PUNËS NË
PROKURORITË ME JURIDIKSION TË PËRGJITHSHËM NË FUNKSION TË
PARANDALIMIT TË PËRHAPJES SË INFEKSIONIT NGA COVID-19**

Në mbështetje të neneve 148/b shkronja "b" "c", të Kushtetutës së Republikës së Shqipërisë, neneve 38 pika 2 shkronja "c", të ligjit nr.97/2016 "*Për organizimin dhe funksionimin e Prokurorisë në Republikën e Shqipërisë*", vendimit datë 09.03.2020 të Komitetit të Përkohshëm për Infeksionimin e Përhapur nga COVID-19, duke pasur në konsideratë situatën e krijuar në vend si rrjedhojë e pandemisë dhe në vijim të masave të marra sipas udhëzimit nr.3, datë 19.3.2020 të Prokurorit të Përgjithshëm

U D H Ë Z O J:

**KREU I
DISPOZITA TË PËRGJITHSHME**

**Neni 1
Qëllimi**

Ky udhëzim i përgjithshëm ka për qëllim për të siguruar mbrojtjen nga infeksioni i shkaktuar nga COVID-2019 të shëndetit të punonjësve në administratën e prokurorive me juridiksion të përgjithshëm dhe të shëndetit të shtetasve të interesuar për shërbime në prokurori, si dhe mbarëvajtjen e punës në prokuroritë me juridiksion të përgjithshëm.

**Neni 2
Objekti**

Objekti i këtij udhëzimi të përgjithshëm është përcaktimi i masave administrative në prokuroritë me juridiksion të përgjithshëm për shkak të situatës së krijuar nga infeksioni i shkaktuar nga COVID-2019.

KREU II MASAT ADMINISTRATIVE

Neni 3

1. Drejtuesit e prokurorive me juridiksion të përgjithshëm, në kuadrin e situatës së krijuar nga infeksioni i shkaktuar nga COVID-2019 dhe masave të nevojshme për mbarëvajtjen dhe funksionimin e prokurorive pranë gjykatave që ushtrojnë funksionet, të vlerësojnë dhe vendosin marrjen e masave për:

i) Kufizimin e kryerjes së veprimeve hetimore që kanë të bëjnë me marrjen e deklarimeve nga personat që kanë dijeni mbi faktet, personat nën hetim apo të pandehurit, përveç rasteve kur nga vonesa mund të dëmtohen hetimet, ose një gjë e tillë nuk mund të shtyhet për shkak të afateve procedurale.

ii) Kufizimin e veprimeve procedurale që zhvillohen në ambientet e spitaleve, ambulancave apo laboratorëve mjekësore dhe kur nuk është e mundur, duke u pajisur në çdo rast me masat e pajisjet për mbrojtjen fizike të domosdoshme.

iii) Kufizimin e veprimtarisë administrative të zyrave të sekretarisë në çdo prokurori në kontaktet me qytetarët, për t'i kryer me anë të komunikimeve nëpërmjet shërbimit postar ose mënyra të tjera që sigurojnë kontakte të pakta fizike.

iv) Kufizimin e orareve të takimit me qytetarët ose subjektet me status të posaçëm nga koordinatorët përkatës, prokurori për marrëdhënit me publikun, drejtuesi i prokurorisë, drejtuesit e seksioneve apo prokurorët. Në vendin e caktuar ku është bërë shpallja e orarit të pritjes së qytetarëve të shpallet kufizimi i kësaj veprimtarie, deri në një moment të dytë që do të vlerësohet nga ana e drejtuesit të prokurorisë.

v) Kufizimin e mbledhjeve, analizave, takimeve në ambientet e prokurorisë ose zyrave të policisë, ku ka pjesëmarrje të lartë të personave të përfshirë.

vi) Në çdo rast kur nga rrethanat rezulton prania e shtuar e personave në sallat e gjyqit të çmohet nga prokurori për t'i kërkuar gjykatës zhvillimin e seancave gjyqësore me dyer të mbyllura referuar në nenin 340 të K.Pr.Penale.

KREU III ZBATIMI, HYRJA NË FUQI DHE PUBLIKIMI

Neni 4

Zbatimi dhe mbikëqyrja

1. Ky udhëzim i përgjithshëm është i detyrueshëm për zbatim nga drejtuesit e prokurorive, prokurorët, oficerët e policisë gjyqësore të seksioneve, oficerët e policisë gjyqësore të shërbimeve

të të gjithë llojeve dhe niveleve dhe nëpunësit civil e punonjësit e administratës të gjithë niveleve, në prokuroritë me juridiksion të përgjithshëm¹.

2. Me mbikëqyrjen e zbatimit të këtij udhëzimi ngarkohen drejtuesit e prokurorive me juridiksion të përgjithshëm².

3. Drejtuesit e prokurorive mund të nxjerrin udhëzime të përgjithshme për lehtësimin e zbatimit të këtij udhëzimi të përgjithshëm³.

Neni 5

Hyrja në fuqi, afati i zbatimit dhe publikimi

1. Ky udhëzim i përgjithshëm hyn në fuqi menjëherë dhe detyrimet e përcaktuara në të zbatohen për një periudhë dy-javore nga hyrja në fuqi e këtij udhëzimi.

2 Udhëzimi i përgjithshëm të publikohet në faqen e internetit të Prokurorisë së Përgjithshme.

PROKUROR I PËRGJITHSHËM

OLSIAN ÇELA



Datë 24.03.2020

¹ Shih nenin 46 pika 1 dhe nenin 6 pika 2 të ligjit nr.97/2016.

² Shih po aty nenin 43 shkronja "dh".

³ Shih po aty nenin 46 pika 4.